

Besnik Tahiri: Gjashtë vendet e Ballkanit
Perëndimor duhet të ecin së bashku drejt BE-së



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



MERR FUND BLOKADA PËR BUXHETIN NË KRYEQYTET, MINISTRIA E FINANCIVE ALOKON NJË PJESË TË MJETEVE FINANCIARE



Ministri në detyrë i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka njoftuar të martën se janë alokuar mjetet në kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë prej 2.7 milionë eurosh, të nevojshme për pagesën e operatorëve të transportit publik, sipas vendimit të Kuvendit të Prishtinës për të hyrat vetjake. Ndërkaq, ka theksuar se pjesa e tjetër nuk mund të kryhej të martën meqë “kapitalet, duke qenë në shumë linja, marrin kohë më gjatë”. Kurse kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se ky është një lajm i mirë për qytetarët dhe punëtorët e kryeqytetit: “Më në fund ka filluar alokimi i pjesshëm i mjeteve financiare prej 25 milionë eurosh nga bartja e vitit 2024 nga Ministria e Financave drejt kryeqytetit”

KQZ-ja MIRATON REKOMANDIMIN PËR PROCEDURAT EKSTREME PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT



POLICIA PAJISËT ME 41 VETURA TË REJA PËR PATRULLIM



OPINION

RËNDËSIA E ANËTARËSIMIT TË KOSOVËS NË INTERPOL

Shkruan:
Kolë KRASNIQI



AKTUALE



ARRESTOHET FEDERICA MOCHERINI, E DYSHUAR PËR MASHTRIM

PARASHIKIMI I MALIQIT PËR ZGJEDHJET: LV-ja DEL E PARA, PDK-JA DHE LDK-JA AVANCOJNË SHUMË, S'KA PARTI QË S'E KALON PRAGUN

EKONOMI



SUPERFUQITË FINANCIARE TË SHEKULLIT XXI: KORPORATAT PO ZËVENDËSOJNË SHTETET

ÇITAKU, AKUZA NDAJ LV-SË: PASUROI 'MAFINË ENERGJETIKE' DHE BLOKUI PROJEKTET JETIKE

RENOVA

PUTZ

Magedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

ARRESTOHET FEDERICA MOGHERINI, DYSHOHET PËR MASHTRIM

BRUKSEL, 2 DHJETOR - Ish-shefja e politikës së Jashtme e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, u arrestua të martën gjatë një bastisjeje policore si pjesë e një hetimi kundër një skeme të dyshuar mashtrimi, e cila lidhet me trajnimin e diplomatëve evropianë. Mogherini, e cila ishte përfaqësuese e lartë për punët e jashtme nga viti 2014 deri më 2019, tani drejton kolegjin pasuniversitar College of Europe, ambientet e të cilit u bastisën së bashku me zyrat e shërbimit diplomatik të EEAS-it. Mogherini ka ndërmjetësuar për disa vjet dialogun midis Kosovës dhe Serbisë. Italia, 52-vjeçare, u arrestua në Bruksel së bashku me zëvendësshefin e shkollës së trajnimit dhe Stefano Sanninon, një zyrtar i lartë i BE-së që ishte sekretar i

përgjithshëm i EEAS-it nga viti 2021 deri në vitin 2024, raportojnë AFP dhe agjenci të tjera ndërkombëtare. Zyra e Prokurorit Publik Evropian (EPPO) njoftoi se kontrolle u kryen në College of Europe në qytetin belg Bruzh, si dhe në ambientet e Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm në Bruksel. “Tre të dyshuar u arrestuan” në lidhje me bastisjet, si “pjesë e një hetimi për mashtrim të dyshuar të lidhur me trajnimin e financuar nga BE-ja për diplomatët e rinj”, thuhet në deklaratën e EPPO-s. Këto kontrolle, të kryera nga policia federale belge me kërkesë të EPPO-s, kishin në shënjestër edhe banesat e të dyshuarve, thanë prokurorët. Në qendër të çështjes, sipas EPPO-s, është një program trajnimi nëntëmuor për diplomatët e rinj nga shtetet e BE-së, i njohur si Akademia



Diplomatike e Bashkimit Europe nga EEAS-i në Evropian. Programi iu dha College of periudhën 2021-2022 dhe hetimi fokusohet nëse procesi i

tenderimit është manipuluar për ta favorizuar këtë shkollë. Mogherini është drejtuese e College of Europe dhe e Akademisë Diplomatike të BE-së. “Ekzistojnë dyshime të forta se... informacioni i besueshëm në lidhje me prokurimin është ndarë me njërin prej kandidatëve pjesëmarrës në tender”, thuhet në deklaratën e EPPO-s. Komisioni Evropian konfirmoi se bastisjet janë kryer. “Ne mund të konfirmojmë se policia ishte sot në ndërtesat e EEAS-it dhe kjo është pjesë e hetimit në vijim për aktivitetet që kanë ndodhur më parë, gjatë mandatit të mëparshëm”, tha zëdhënësja e Komisionit, Anitta Hipper. Diplomati e tanishme më e lartë e BE-së, përfaqësuesja e lartë për punët e Jashtme, Kaja Kallas, e mori detyrën një vit më parë nga pasardhësi i Mogherinit, Josep Borrell.

BE-ja SYNON SANKSIONE TË REJA NDAJ BJELLORUSISË PËR SHKAK TË “SULMIT HIBRID” NË LITUANI

Bruksel, 2 dhjetor - Bashkimi Evropian po përgatit sanksione të reja kundër qeverisë së presidentit bjellorus Aleksandar Lukashenko të cilën e akuzon për një fushatë “hibride” kundër Lituanisë fqinje, tha të hënën shefja e BE-së, Ursula von der Leyen. Lituania e mbylli kufirin me Bjellorusinë në tetor pasi dhjetëra balona të ngarkuara me cigare të paligjshme hynë në hapësirën e saj ajrore, duke detyruar disa aeroporte të mbyllen dhe duke nxitur tensione mes dy vendeve. “Gjendja në kufi me Bjellorusinë po përkeqësohet, me



shpeshimin e futjes së balonave të kontrabandës në hapësirën ajrore të Lituanisë”, shkroi presidentja e Komisionit

Evropian në X pas bisedimeve me presidentin lituanëz Gitanas Nauseda. “Një sulm i tillë hibrid nga regjimi i Lukashenkos është

plotësisht i papranueshëm. Lituania vazhdon të ketë mbështetjen tonë të plotë”, tha von der Leyen, duke shtuar se “ne po përgatisim masa të mëtejshme në kuadër të regjimit tonë të sanksioneve”. Mbyllja e kufirit në tetor la mijëra kamionë lituanë të bllokuar në Bjellorusi. Disa prej tyre ende ndodhen atje të ngecur, dhe Vilnisi e ka akuzuar Minskun për “shantazh” lidhur me miliona euro mallra të mbetura. Ndërkohë, shërbimi diplomatik i BE-së tha se e ka thirrur të hënën të dërguarin e Bjellorusisë në takim për shkak të “veprimeve hibride që burojnë nga territori

bjellorus dhe që përbëjnë një kërcënim për BE-në”, përfshirë edhe “çështjen e papranueshme” të kamionëve të bllokuar. BE-ja ka vendosur sanksione vazhdimisht ndaj Minskut që nga viti 2020 - duke përfshirë edhe ato ndaj Lukashenkos dhe familjes së tij - për shtypjen brutale të kundërshtarëve dhe për mbështetjen e luftës së Moskës në Ukrainë. Lukashenko është aleat i ngushtë i presidentit rus Vladimir Putin dhe e lejoi Moskën ta përdorte vendin për ta nisur pushtimin e Ukrainës në vitin 2022.

NIS E MERR LEJEN PËR TA NDËRPRERË PUNËN, NË PRITJE TË NJË VENDIMI NGA SHBA PËR LICENCËN

BEOGRAD, 2 DHJETOR - Presidenti serb Aleksandar Vuçiq njoftoi të martën se Shtetet e Bashkuara nuk kanë marrë ndonjë vendim për zgjatjen ose jo të licencës së punës për Industrinë e Naftës së Serbisë (NIS) të cilën e sanksionoi muajin e kaluar për shkak të pronësisë së saj ruse. NIS-i është ende duke e pritur një përgjigje nga autoritetet amerikane për kërkesën e saj për ta lejuar atë të veprojë derisa po i vazhdon bisedimet për t'i shitur aksionet e veta ruse. “Rusët nuk duan t'i shesin aksionet e tyre në NIS. Nuk ka të bëjë me paratë, ka të bëjë me

politikën”, tha Vuçiqi në një konferencë për shtyp të martën, pas një takimi me ekipet përgjegjëse për stabilitetin dhe sigurinë energetike të vendit. Vuçiqi theksoi se nuk ka ndonjë tregues se ShBA-ja do t'ia vazhdojë licencën NIS-it. Pa licencë, rafineria e naftës në Pançevë, e cila operon brenda NIS-it, do të detyrohet ta pushojë veprimtarinë plotësisht për shkak të mungesës së naftës së papërpunuar. Vuçiqi tha se ministrja e Minerave dhe Energjisë së Serbisë, Dubravka Gjedorviq



Handanoviq, do ta njoftojë NIS-in për këtë dhe se është dhënë leja që rafineria e NIS-it në Pançevë ta ndërpresë punën. “NIS-i do të vendosë nëse rafineria do ta pushojë veprimtarinë sot apo në ditët në vijim”, tha Vuçiq. Ai tha se është dita e 54-të qëkurse u vendosën sanksione

ndaj NIS-it dhe se nuk ka probleme me furnizimin me karburant, “gjë që tregon se sa serioz është shteti dhe sa para janë investuar në rezervat e naftës dhe produkteve të naftës”. Departamenti Amerikan i Shtetit nuk i ishte përgjigjur një pyetjeje të Radios Evropa e Lirë deri më 1 dhjetor nëse Zyra e Kontrollit të Aseteve të Huaja (OFAC) e Departamentit të Thesarit kishte marrë ndonjë vendim në lidhje me kërkesën e NIS-it dhe se kur mund të pritej ky vendim. Në një seancë më 25 nëntor, ku

mori pjesë edhe Vuçiqi, qeveria serbe miratoi një vendim për t'i dhënë Rusisë 50 ditë për të gjetur ndonjë blerës për aksionet e saj. Moska u paralajmërua se, nëse nuk e bën, atëherë Serbia do ta prezantojë menaxhimin e vet në NIS dhe do t'i ofrojë palës ruse “çmimin më të lartë të mundshëm” për kompaninë. As pala amerikane dhe as ajo ruse nuk kanë publikuar informacione rreth përparimit të bisedimeve dhe qytetarët janë njoftuar për këtë gjendje nga zyrtarët serbë, kryesisht nga presidenti Vuçiq.

Maqedonci mori pjesë në sesionin plenar të Ministerialit ShBA - Karta e Adriatikut (A5)

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Në sesionin plenar të Ministerialit ShBA - Karta e Adriatikut (A5), ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, theksoi se Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për ta forcuar qëndrueshmërinë kombëtare dhe bashkëpunimin rajonal. Ministri Maqedonci tha se Kosova po ndjek një qasje të koordinuar ndërmjet institucioneve civile dhe atyre ushtarake në përputhje me

standardet e NATO-s për t'u përballur me krizat, kërcënimet kibernetike dhe operacionet hibride. Ministri theksoi rreziqet nga aktorë shtetërorë, duke përmendur sulmin terrorist të 24 shtatorit të vitit 2023 në Banjaskë dhe mbështetjen e papranueshme nga Serbia ndaj përgjegjësve të këtij sulmi, i cili cenon stabilitetin e rajonit. Ministri tha se Kosova mbetet e

përkushtuar ndaj transparencës, bashkëpunimit dhe vlerave euroatlantike dhe se Kosova është e gatshme të bashkëpunojë me çdo partner që ndjek rrugën e paqes, përgjegjësisë dhe respektit të ndërsjellë. Vetëm përmes koordinimit rajonal, ushtrimeve të përbashkëta, mbrojtjes kibernetike dhe përgjegjësisë politike mund të ndërtohet një rajon më i sigurt dhe më i qëndrueshëm.



KQZ-ja MIRATON REKOMANDIMIN PËR PROCEDURAT EKSTREME PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur të martën mbledhjen e 86, të kryesuar nga kryesuesi Kreshnik Radoniqi. Në fillim të mbledhjes, pas fillimit të periudhës për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës për të votuar në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, KQZ-ja mori vendim për formimin e Komisionit për Kundërshtimin Administrativ. Në rast të refuzimit të aplikimit për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës, te ky komision mund të parashtrahet kundërshtimi kundër njoftimit të KQZ-së. Çdo person, të cilit i refuzohet



kundërshtimi administrativ, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankese dhe Parashtresa (PZAP) brenda 48 orëve nga momenti i pranimit të vendimit të KQZ-së për refuzim.

Në pikën tjetër të rendit të ditës, KQZ-ja mori vendim për miratimin e rekomandimit të Sekretariatit të KQZ-së për zhvillimin e procedurave emergjente ekstreme për aktivitetet e prokurimit që

lidhen me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës të cilat do të mbahen më 28 dhjetor 2025. Këto përfshijnë një sërë aktivitete të domosdoshme për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme. Në kuadër të vazhdimit të përgatitjeve për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, KQZ-ja mori vendim për miratimin e specifikimeve teknike për shtypjen e fletëvotimeve, broshurave të kandidatëve dhe listave të votuesve. Dokumenti i miratuar është për qëllim të tenderimit të shtypjes së fletëvotimeve, broshurave të kandidatëve si dhe listave të votuesve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Dizajni dhe numri i

saktë i fletëvotimeve që do të shtypen, do të vendoset nga KQZ në një fazë të mëvonshme, pas certifikimit të subjekteve politike, kandidatëve dhe listës së votuesve. Në vazhdim të mbledhjes, KQZ-ja mori vendim për emërimin e 215 anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve në 38 komunat e Republikës së Kosovës, të cilët përfaqësojnë subjektet e ndryshme politike. Sipas Ligjit nr. 08/L-288 për Zgjedhjet e Përgjithshme, KQZ administron zgjedhjet brenda komunës përkatëse, nën mbikëqyrjen ekskluzive dhe udhëzimet e KQZ-së, duke garantuar ligjshmëri, legjitimitet dhe efikasitet të procesit zgjedhor.

BESNIK TAHIRI: GJASHTË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR DUHET TË ECIN SË BASHKU DREJT BE-së

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Në tryezën e CIG Western Balkans, të mbajtur në Sarajevë, me temën "Si ta bëjmë të funksionojë rruga e Bosnjë-Hercegovinës drejt BE-së", nënkryetari i AAK-së, Besnik Tahiri, ka theksuar nevojën që liderhipi politik të fokusohet më shumë në mendim dhe veprim strategjik sesa në debatet teknike. "Për Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën dhe gjithë rajonin, përparimi për një të ardhme evropiane varet nga respektimi i angazhimeve dhe nga zbatimi i tyre që në kohë sfiduese sollën paqen dhe shtetësinë. Për vlerësimin

tim, dy fakte janë të pandryshueshme: identitetet tona kombëtare do të mbeten, dhe identiteti ynë përbashkët shtetëror është thelbësor për paqen, të ardhmen dhe integritetin në BE. Këto identitete nuk janë në konflikt; ato bashkëjetojnë sepse të gjitha palët në Bosnjë dhe Hercegovina dolën fituese në vitin 1995 me Marrëveshje të Dejtonit dhe Planin e Ahtisaarit", ka thënë Tahiri. Përndryshe, sipas tij, reformimi i sistemit politik dhe kushtetues, duke përfshirë edhe zëvendësimin eventuale të përfaqësuesit të lartë në Bosnjë-Hercegovinë,



është i mundur vetëm përmes një angazhimi të sinqertë për anëtarësim në

BE, nga lideri në Sarajevë dhe Bruksel. "Përndryshe, Ballkanit Perëndimor ka

nevojë tani për një qasje të re, gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të afrohen dhe të ecin përpara së bashku drejt BE-së. Kjo nuk është thjesht vetëm një ndihmë për rajonin tonë, por një investim strategjik në stabilitetin e vet Evropës", është shprehur Tahiri. Ai ka theksuar se paqja është e kushtueshme, por mbetet e vetmja rrugë e qëndrueshme, ndërsa kompromisi i vitit 1995 në Dejton kurrë nuk duhet harruar, se e bëri të mundur paqen, duke mos qenë koncesion, por kompromis që mundësoi shumë zhvillime pozitive në Ballkanin Perëndimor.

FSK-ja realizon "Kursin bazik për materie të rrezikshme"

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Kompania e Materieve të Rrezikshme e Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës ka realizuar

"Kursin bazik për materie të rrezikshme", me qëllim të aftësisë dhe përgatitjes së pjesëtarëve të Kompanisë së

Materieve të Rrezikshme për kryerjen e detyrave sipas misionit dhe rritjen e aftësive operacionale të Kompanisë së

Materieve të Rrezikshme (KMRR) në menaxhimin dhe përballimin e incidenteve me materie të rrezikshme.





MERR FUND BLOKADA PËR BUXHETIN NË KRYEQYTET, MINISTRIA E FINANCEVE ALOKON NJË PJESË TË MJETEVE FINANCIARE

Ministri në detyrë i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka njoftuar të martën se janë alokuar mjetet në kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë prej 2.7 milionë eurosh, të nevojshme për pagesën e operatorëve të transportit publik, sipas vendimit të Kuvendit të Prishtinës për të hyrat vetjake. Ndërkaq, ka theksuar se pjesa e tjetër nuk mund të kryhej të martën meqë “kapitalet, duke qenë në shumë linja, marrin kohë më gjatë”. Kurse kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se ky është një lajm i mirë për qytetarët dhe punëtorët e kryeqytetit: “Më në fund ka filluar alokimi i pjesshëm i mjeteve financiare prej 25 milionë eurosh nga bartja e vitit 2024 nga Ministria e Financave drejt kryeqytetit”

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 2 dhjetor - Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar të martën se janë alokuar mjetet në kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë prej 2.7 milionë eurosh, të nevojshme për pagesën e operatorëve të transportit publik, sipas vendimit të Kuvendit të Prishtinës për të hyrat vetjake. “Kjo pjesë është proceduar veçmas nga pjesa tjetër prej 25.9 milionë eurove e projekteve kapitale në mënyrë që të kryhet sot me prioritet, sepse kapitalet duke qenë në shumë linja marrin kohë më gjatë dhe nuk ishte e mundur të kryeshin sot. Vendimi i marrë nga Komuna e Prishtinës të enjten në mbrëmje për të hyrat vetjake, sipas legjislacionit në fuqi fillimisht duhej të kalonte verifikimin e ligjshmërisë, proces

ky që bëhet nga ana e MAPL-së. Në rastet kur vendimi ka të bëjë me çështje financiare / buxhetore, ligjshmëria duhet të verifikohet edhe nga MFPT-ja. Ky proces, pra verifikimi i ligjshmërisë është kryer dje në afat rekord nga të dyja ministritë, edhe nga MAPL edhe nga MFPT, ashtu siç u pata premtuar në takim përfaqësuesve të sindikatave të transportuesve publikë. Para ditës së djeshme ka qenë e pamundur të kryhej ky proces sepse siç e dini e premtja dhe fundjava nuk ishin ditë pune”, ka shkruar Murati në “Facebook”. Ndërkaq, sipas tij, të martën Departamenti i Buxhetit ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me zyrtarët financiarë të komunës së Prishtinës për të siguruar procedurën sa më të shpejtë, që nënkupton se komuna ka qenë e informuar përgjatë tërë procesit dhe për ecurinë e alokimit.

“Prandaj është për keqardhje sjellja e deklaratatave dezinformuese nga ana e Komunës së Prishtinës që gjoja Ministria nuk po bën alokimin e mjeteve, kur në fakt edhe ata vetë e dinë që kemi të bëjmë me procedurë që nuk mund të tejkalohet. Gjithsesi, uroj që komuna të ketë vlerësuar saktë obligimet financiare në kategorinë mallra dhe shërbime, kur ka vendosur të ndajë vetëm 2.7 milionë euro, dhe tash të shlyejë të gjitha borxhet që ka ndaj operatorëve të transportit publik, e me këtë të marrë fund edhe farsa për gjoja bllokadën e pretenduar”, ka thënë Murati. Ndërkaq kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se ky është një lajm i mirë për qytetarët dhe punëtorët e kryeqytetit. “Më në fund ka filluar alokimi i pjesshëm i mjeteve financiare prej 25 milionë euro nga bartja e vitit

2024 nga Ministria e Financave drejt kryeqytetit. Drejtoria e Financave e kryeqytetit do të vazhdojë punën sot, jashtë orarit të rregullt të punës, me qëllim të procesimit sa më të shpejtë të pagesave. Në përputhje me dinamikën e alokimit të mjeteve nga Ministria, ne si komunë do të vazhdojmë me procesimin e pagesave në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt. Presim që sa më shpejtë të përfundojë alokimi i plotë i shumës prej 25 milionë eurosh nga Ministria. Falënderojmë qytetarët dhe punëtorët për mirëkuptimin, durimin dhe bashkëpunimin!”, ka shkruar Rama në “Facebook”. Në një postim para këtij, Rama kishte reaguar ashpër ndaj Ministrisë së Financave dhe ministrit në detyrë, Hekuran Murati, duke e akuzuar për bllokim të qëllimshëm të mjeteve financiare që, sipas tij, po pengojnë pagesën e punëtorëve të “Trafikut Urban” dhe operatorëve privatë të transportit publik. “Pse nuk po i qet paret, Hekuran? Shërbimet janë ndalur. Punëtorët janë pa paga. Komuna po pret transferimin e mjeteve nga ministria! Javën e kaluar e votuam bartjen e mjeteve, ndonëse këto obligime kanë mundur të mbulohen lehtësisht nga 35 milionë euro të hyrat

vetanake dhe nga granti qeveritare që, për ironi, as nuk kërkojnë votim në Asamblë, vetëm vullnet për miratim nga ministri në detyrë, por që vazhdon t'i mbajë të bllokuara me përkushtim!”, ka shkruar Rama në “Facebook”. Ai ka thënë se meqë politika spektakolare paska prioritet, janë detyruar të ndjekin çdo rrugë tjetër vetëm që punëtorët të marrin pagat e tyre. “E thirrëm edhe seancën e jashtëzakonshme për t'i votuar 25 milionë euro nga të hyrat e vitit 2024, të njëjtat mjete që tri herë radhazi u bllokuan nga asamblistët e VV-së. Këtë herë u votuan. U lëshuan në ofensivë publike duke thënë se ‘VV e shpëtoi kryeqytetin’. Po harrojnë që qytetarët janë vigjilentë dhe e dinë se, nëse VV nuk do ta kishte bllokuar buxhetin, nuk do të kishte pasur nevojë për ‘Çbllokim’. Sidoqoftë, i falënderojmë të gjithë ata që në fund votuan në dobi të interesit publik. Tani vjen pyetja elementare, ajo që nuk kërkon as debat politik, as konferencë për media: Çfarë po prisni saktësisht? Një krizë tjetër artificiale për konsum elektoral? Apo thjesht po ushtroni versionin tuaj të varfër të pushtetit: mbajtjen peng të mjeteve publike për interesa ditore?”, ka shkruar kryetari i Prishtinës, Përparim Rama.

MBROJTJA E THAÇIT AKUZON GJYQTARËT SE IA VAZHDUAN PARABURGIMIN ME VENDIME KONTRADIKTORE

HAGË, 2 DHJETOR - Hashim Thaçi po vazhdon përballjen me drejtësinë e Dhomave të Specializuara të Hagës në dy raste të ndryshme. Në njërin rast, Thaçi akuzohet për krime të luftës në procesin që ka nisur që prej vitit 2020, kurse në rastin tjetër për pengim të drejtësisë. Megjithatë, në standardet me të cilat po vendoset për paraburgimin e Thaçit, sipas mbrojtjes, ka kontradikta. Përderisa në rastin kryesor, për Thaçin është vlerësuar se nuk ka rrezik të arratisjes, në rastin e pengimit të drejtësisë, ende po përmendet kjo arsye. Dhe ky fakt ka marrë vëmendjen e avokatit të Thaçit. “Mbrojtja vëren se gjyqtari i procedurës paraprake në rastin e pengimit dhe trupi gjykues në rastin 06 arritën në gjetje të kundërta mbi kriteret e para të Nenit 46(6)(b) - rreziku i arratisjes - pavarësisht se trajtuan rrethana faktike, materialisht identike. Në të vërtetë, ndërsa këto procedura janë të pavarura nga njëra-tjetra, ekziston një lidhje e natyrshme midis tyre, duke përfshirë edhe sa iu përket dëshmitarëve dhe provave. Për qëllimet e këtij shqyrtimi, mbivendosja më e rëndësishme midis dy rasteve është vetë z. Thaçi”, thuhet në këtë dokument, raporton “Nacionale”. Mbrojtja pohon se Thaçi nuk ka

një rrezik i keqe, qoftë në rastin 12 apo rastin 06, dhe se specifikimi i rastit nuk justifikon një gjetje të ndryshme nga ajo e miratuar në rastin 06. “Gjyqtarja e procedurës paraprake ndoqi një qasje të gabuar në vlerësimin e saj të rrezikut të ikjes që nga caktimi i saj. Duke deklaruar se ky rrezik duhet të vlerësohet në mënyrë të pavarur në kontekstin e secilit rast, ajo gabimisht identifikoi një rrezik më të lartë arratisjeje në këtë rast sesa në rastin 06, pavarësisht se ky rast përfshin akuza shumë më pak serioze. Në kundërshtim me gjetjet e gjyqtarit të procedurës paraprake, siç tregohet më poshtë, z. Thaçi ka edhe më pak rrezik të arratisjes në rastin 12 sesa në rastin 06”, thuhet më tutje. Ajo çka vlen të theksohet është se tash e disa kohë gjyqtarët në rastin e kërërve të UÇK-së kanë theksuar se Hashim Thaçi nuk ka rrezik të arratisjes, andaj i kanë kërkuar prokurorisë që të mos e bëjë kërkesën e njëjtë. “Paneli ka shqyrtuar argumentet e prokurorisë në dritën e fazës aktuale të procedurës, dhe përderisa rreziku i arratisjes nuk mund të përjashtohet kurrë plotësisht, ai ripohon se nuk gjen ndonjë faktor shtesë mjaftueshëm bindës për ta bindur panelin ta ndryshojë vendimin e mëparshëm në lidhje

me rrezikun e ikjes”, thuhej në vendimet e fundit për Thaçin. “Mbrojtja pohon se trupi gjykues në rastin 06 kishte të drejtë dhe se Thaçi tashmë përballlet me akuza në lidhje me krime kryesore ndërkombëtare që, nëse dënohen, mund të tërheqin një dënim shumë më të madh me burgim sesa akuzat në rastin konkret. Prandaj, mbrojtja e refuzon pretendimin e Prokurorisë Speciale se rëndësia e veprave penale në rastin konkret dhe dënimi i tyre i mundshëm përcaktojnë një rrezik real arratisjeje, në rrethana kur trupi gjykues në rastin 06 tashmë ka konsideruar se ato nuk e bëjnë. Mbrojtja vëren se vetë presidentja e Speciales vendosi të emërojë një gjyqtar të vetëm gjykues, në vend të një trupi gjykues, në rastin aktual, sepse ajo vërejtë se “akuzat kundër të gjithë të akuzuarve në këtë rast nuk klasifikohen si krime të rënda sipas Nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës”. Në mënyrë të ngjashme, në kontekstin e një çështjeje të mëparshme që përfshinte vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, Dhoma e Gjykatës së Apelit vuri në dukje se, megjithëse interesi publik në mbrojtjen e integritetit të procedurave përmes ndjekjes efektive të veprave penale kundër administrimit të drejtësisë nuk



duhet nënvlerësuar, vepra të tilla penale nuk janë aq të rënda sa krimet kryesore sipas neneve 13 dhe 14 të ligjit. Kjo vërteton më tej faktin se akuzat e rastit 12 janë më pak të rënda se akuzat e rastit 06 dhe se çdo rrezik i keqe është më pak i rëndësishëm në rastin 12 sesa në rastin 06”, thuhet në parashtrësën e re. Mbrojtja ka argumentuar se Thaçi disa herë u lirua për arsye humanitare dhe ai nuk pati asnjë synim për arratisje. “Përkundrazi, mbrojtja pohon se sjellja e fundit e z. Thaçi tregon se ai është i gatshëm t’u përmbahet rregullave të vendosura ndaj tij dhe nuk është në rrezik i keqe. Mbrojtja thekson se z. Thaçi është lëruar përkohësisht disa

herë - nën shoqërim - në Kosovë, për t’u takuar me të afërmit e tij të ngushtë, hera e fundit ka qenë në mars të vitit 2025, dhe se ai është kthyer në Njësinë e Paraburgimit në Hagë pa incidente. Në asnjë moment z. Thaçi nuk ka treguar ndonjë qëllim për t’u arratisur, ndërsa ka qenë në dijeni të akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe rendit publik kundër tij në rastin 12, dhe të provave të paraqitura nga ZPS në mbështetje të akuzave të tilla”, thuhet më tutje. Procesi gjyqësor në rastin e pengimit të drejtësisë pritet të fillojë gjatë shkurtit, nëse nuk ka ndonjë ndryshim në kalendarin e punës.

PARASHIKIMI I MALIQIT PËR ZGJEDHJET: LV-ja DEL E PARA, PDK-ja DHE LDK-ja AVANCOJNË SHUMË, S’KA PARTI QË S’E KALON PRAGUN



PRISHTINË, 2 DHJETOR - Publicisti i njohur Shkëlzen Maliqi, në një intervistë dhënë për “Gazeta Blic”, ka folur në lidhje me rezultatin që pritet të kenë subjektet politike në zgjedhjet e 28 dhjetorit. Maliqi parashikon se në zgjedhjet e dhjetorit, LV-ja do të dalë sërish parti e parë, por PDK-ja dhe LDK-ja do të avancojnë shumë. Ai ka theksuar se s’do të ketë subjekte politike që nuk e kalojnë pragun. “Nuk ka më subjekte politike që nuk e kalojnë pragun.

Ka qenë AAK-ja në rrezik, por mendoj se edhe sukcesi në zgjedhjet lokale tregon se 5 % duhet ta kalojë. Do të ishte befasi nëse nuk e kalon sepse ka struktura lokale të forta dhe është parti e organizuar. Shumica e partive janë rehatuar nëpër subjektet ekzistuese, por mendoj se prapë Lëvizja Vetëvendosje mundet me qenë subjekt i parë, por i dyti dhe i treti do të avancojnë. PDK-ja, së paku në Drenicë, ku është bastioni i saj tradicional, nuk do të dalë e

përçamë si në zgjedhjet lokale, kështu që mund ta rritë pak votën, ndoshta 250 mijë ose edhe më shumë votues. Edhe LDK-ja është mobilizuar dhe angazhuar. Ajo kërkon vota tek ata votues që në 2021-n ia kanë dhënë përparësinë e madhe Vetëvendosjes dhe Kurtit, kur Vjosa Osmani ua ka dhënë ‘peshqesh’ 100 mijë vota. Gjysma e tyre nuk e votuan herën e kaluar, tash pritet edhe gjysma tjetër së paku të luhatet”, ka pohuar Maliqi.

Haziri: Kosova sot është pa Kuvend, pa qeveri dhe pa buxhet

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, ka bërë një postim në “Facebook” në prag të zgjedhjeve të jashtëzakonshme të 28 dhjetorit, duke deklaruar se vendi ndodhet në një krizë të thellë politike dhe se vetëm LDK-ja mund ta rikthejë stabilitetin institucional. “Ne kemi shkaktuar procese e kemi realizuar ëndrra, koha që

populli t’ia kthej krejt dashninë LDK-së. Me unitet të plotë, kemi nderin që e nominuam për kryeministër kryetarin tonë, dr. Lumir Abdzhikun, që do të përkthehet me unitet qytetar në zgjedhjet e jashtëzakonshme të 28 dhjetorit. E filluam vitin me zgjedhje e po rikthehemi prapë në zgjedhje parlamentare. Nëse kërkohet arsyeja e shëndosh, përse?! Është e

thjeshtë. Mungoi bashkëpunimi e vullneti dhe vendi u bllokua në një krizë politike të planifikuar e të menaxhuar. Kosova sot as nuk është më e pavarur, as më e lirë e as më demokratike”, ka thënë Haziri. Ai ka theksuar se sot vendi është pa Kuvend, pa qeveri dhe shpejt edhe pa buxhet shteti, me një krizë të re. “Është mundësia që më 28 dhjetor të

mos ecim edhe tutje nëpër terr politik, por t’i kthehemi familjes, atdheut e Zotit. Për një vend ku jetohet më mirë, për familjen e Kosovën, me besë e shpresë që e ofron veç LDK. Ne kemi shkaktuar procese e kemi realizuar ëndrra dhe koha është që populli t’ia kthej krejt dashninë LDK-së. Kosova ka nevojë për dashni. Kosova ka nevojë për LDK-në si asnjëherë më parë!”, ka shkruar Haziri.



RËNDËSIA E ANËTARËSIMIT TË KOSOVËS NË INTERPOL



Shkruan: Kolë KRASNIQI

Anëtarësimi i Kosovës në Interpol ka rëndësi të shumëfishtë dhe prek një spektër të gjerë fushash, nga siguria dhe diplomacia deri te shtetndërtimi. Si organizatë globale e bashkëpunimit policor, Interpoli u mundëson shteteve anëtare shkëmbimin e menjëhershëm të informacioneve, koordinimin operacional dhe akses në databazat vitale ndërkombëtare të të dhënave te ndryshme kriminale. Për Kosovën, kjo do të nënkuptonte forcim të kapaciteteve institucionale në luftimin e krimit ndërkufitar, terrorizmit, trafikimit të qenieve njerëzore dhe korrupsionit, si dhe rritje të efikasitetit në parandalimin dhe luftimin e aktiviteteve kriminale transnacionale.

Në aspektin politik, anëtarësimi në Interpol shërben si një instrument i rëndësishëm diplomatik. Ai kontribuon në afirmimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, në konsolidimin e pozicionit të saj në proceset euroatlantike dhe në rritjen e kredibilitetit të saj ndërkombëtar. Njëkohësisht, anëtarësimi i Kosovës në Interpol do ti mbronte qytetarët e Kosovës nga abuzimet me fletarrestime politike, të cilat Serbia vazhdon t'i përdorë kundër shtetasve kosovarë - veçanërisht ndaj ish pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këtë perspektivë, Interpoli nuk duhet parë vetëm nga aspekti teknik si mekanizëm për bashkëpunim policor, por si një platformë strategjike për afirmimin e shtetësisë së Kosovës dhe për konsolidimin e rolit të saj në skenën ndërkombëtare.

Kundërshtimi i anëtarësimit të Kosovës në Interpol

Serbia e kundërshton anëtarësimin e Kosovës në Interpol për arsye të qarta politike, juridike dhe gjeostrategjike. Së pari, pranimi i Kosovës në këtë organizatë do të nënkuptonte një formë të njohjes funksionale të shtetësisë së Kosovës, duke minuar drejtpërdrejt strategjinë serbe "për mosnjohje ndërkombëtare". Një hap i tillë do të rrëzonte narrativën politike të ngritur nga Serbia se "Kosova nuk është shtet" dhe do

të përmbyste përpjekjet shumëvjeçare të diplomacisë serbe për ta kufizuar subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës.

Së dyti, Serbia synon të ruajë kontroll pothuajse monopolistik mbi narrativën e krimeve të luftës dhe proceset juridike të lidhura me konfliktin e viteve 1998-1999. Duke penguar anëtarësimin e Kosovës në Interpol, Serbia e ruan hapësirën për të lëshuar fletarrestime të motivuara politikisht, për të ndjekur ish-pjesëtarë të UÇK-së në mënyrë selektive dhe për ta përdorur sistemin ndërkombëtar të drejtësisë si instrument për presion diplomatik.

Së treti, Serbia ka ambicie të qarta për t'u pozicionuar si qendra kryesore e sigurisë në Ballkan. Aplikimi i saj për hapjen e Zyrës Rajonale të Interpolit në Beograd është pjesë e kësaj strategjie më të gjerë për të konsoliduar ndikimin rajonal. Një Kosovë e anëtarësuar në Interpol do ta sfidonte këtë pretendim, duke e relativizuar rolin që Serbia synon t'i atribuojë vetes dhe duke kufizuar avantazhin e saj strategjik në fushën e bashkëpunimit policor ndërkombëtar. Për këto arsye, kundërshtimi i Serbisë nuk është thjesht procedural, por thellësisht politik dhe i orientuar drejt delegitimimit të shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Pasojat e mosanëtarësimi të Kosovës në Interpol

Ballkani mbetet një rajon i ekspozuar ndaj niveleve të larta të kriminalitetit transnacional, përfshirë trafikun e drogës, korrupsionin, pastrimin e parave, migrimin ilegal dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Brenda këtij konteksti të ndërlikuar të sigurisë, mosprania e Kosovës në Interpol krijon një "zonë gri sigurie", ku shkëmbimi i informacioneve është më i ngadalshëm, bashkëpunimi policor mbetet i ndërmjetësuar dhe rrjetet kriminale gjejnë mundësi për të shfrytëzuar boshllëqet institucionale. Mosanëtarësimi i Kosovës nga Interpoli e dobëson strukturën e sigurisë në tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ky mosanëtarësim ngadalëson edhe përpjekjet e koordinuara për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, vështirëson kontrollin efektiv të kufijve dhe redukon efikasitetin e përgjigjes rajonale ndaj krimit të organizuar. Kjo nuk përbën vetëm një rrezik për Kosovën, por edhe për shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Serbinë, pasi që "infrastruktura rajonale e



sigurisë është po aq e fortë sa edhe hallka e saj më e dobët".

Shkaqet e mosaplikimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol

Mosaplikimi i Kosovës për anëtarësim në Interpol që nga viti 2018 lidhet me tre faktorë kryesorë. Së pari, mungesa e mbështetjes së mjaftueshme ndërkombëtare ka krijuar një rrezik të theksuar për dështim. Pesë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian që ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, së bashku me ndikimin e Rusisë dhe Kinës në proceset vendimmarrëse të Interpolit, e bëjnë rezultatin e votimit shumë të pasigurt. Së dyti, konsideratat politike të dialogut Kosovë-Serbi kanë ndikuar ndjeshëm në këtë vendimmarrje. Qeveritë kosovare kanë qenë të kujdesshme të shmangin veprime që mund të interpretoheshin si provokuese ose tensionuese në raport me Serbinë, veçanërisht në faza të ndjeshme të negociatave në Bruksel. Së treti, ekziston frika e legjitimuar se një dështim i ri në votim do të instrumentalizohet nga Serbia. Një refuzim tjetër do t'i siguronte Serbisë argumente shtesë në fushatën e saj diplomatike për të contestuar shtetësinë e Kosovës dhe për të dobësuar pozitën e saj në arenën ndërkombëtare.

Përpjekjet serbe për hapjen e Zyrës Rajonale të Interpolit në Beograd

Një seli rajonale e Interpolit në Beograd do t'i siguronte Serbisë përfitime të konsiderueshme strategjike. Para së gjithash, Serbia do të pozicionohej si qendra kryesore e arkitekturës së sigurisë në Ballkan, duke fituar rol të zgjeruar në koordinimin e bashkëpunimit policor rajonal. Një seli e tillë do t'i mundësonte Beogradit qasje më të thelluar në sistemet

globale të të dhënave kriminale, rritje të kapaciteteve për koordinim operativ dhe ndikim më të madh në përcaktimin e prioritetëve të sigurisë rajonale. Ky status i ri institucional do të rriste ndjeshëm peshën politike të Serbisë në raport me Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara dhe organizatat ndërkombëtare, duke e forcuar imazhin e saj si aktor qendror në stabilitetin e Ballkanit. Njëkohësisht, vendosja e kësaj zyre në Beograd do të krijonte një kanal të ri te ndikimit të Rusisë në Ballkanin Perëndimor. Përmes kësaj zyre në Beograd, Moska do të fitonte qasje të tërthortë në proceset e sigurisë rajonale, gjë që do t'i mundësonte asaj të ruante ose të zgjeronte ndikimin e saj gjeopolitik në një zonë ku rivaliteti ndërmjet fuqive të mëdha është tejet i theksuar.

Si do të ndikonte në Kosovë hapjen e Zyrës Rajonale të Interpolit në Beograd

Një rol i zgjeruar i Serbisë brenda Interpolit do të prodhonte pasoja të thella për Kosovën, duke e vendosur atë në një pozitë strukturore të pafavorshme në arkitekturën rajonale të sigurisë. Së pari, Kosova do të mbetej jashtë rrjeteve të integruara të bashkëpunimit policor, gjë që do ta detyronte të vazhdonte të mbështetej në mekanizma ndërkombëtarë ndërmjetësues për shkëmbim të informacioneve. Mungesa e qasjes së drejtpërdrejtë në Interpol do të ngadalësonte ndjeshëm proceset operative të Policisë së Kosovës dhe do të krijonte vonesa në koordinimin e aktiviteteve kundër krimit transnacional. Së dyti, do të shtohet rreziku nga abuzimi me urdhërarreste politike nga Serbia. Një situatë e tillë do të ndikonte drejtpërdrejt

në lirinë e lëvizjes së qytetarëve kosovarë, sidomos të ish-pjesëtarëve të UÇK-së dhe zyrtarëve shtetërorë, duke i ekspozuar ata ndaj arrestimeve të mundshme në shtete që zbaton mekanizmat e Interpolit.

Së treti, Serbia do të fitonte një avantazh të shtuar diplomatik, i cili do ta reduktonte më tej hapësirën e Kosovës për t'u integruar në strukturat ndërkombëtare të sigurisë. Në aspektin praktik, një epërsi e tillë e Serbisë do të ndikonte në perceptimin ndërkombëtar të rolit të Kosovës, si aktor në fushën e sigurisë.

Si do t'i trajtonte Serbia çështjet që lidhen me Kosovën nëse do të hapej Zyra Rajonale të Interpolit në Beograd

Serbia, me shumë gjasë, do të vazhdonte politikën e saj të "mosnjohjes funksionale", duke i trajtuar institucionet e Kosovës si struktura jo-shtetërore dhe duke shmangur çdo formë të bashkëpunimit të drejtpërdrejtë institucional. Një pozicion i tillë brenda Interpolit do t'i mundësonte Serbisë të ushtronte presion të shtuar diplomatik ndaj Kosovës, të avanconte narrativën e saj për krimet e supozuara të luftës dhe të ndikonte në mënyrë të tërthortë në opinionin ndërkombëtar mbi statusin e Kosovës. Përmes këtij mekanizmi, Serbia do të kishte mundësi të pengonte integrimin e Kosovës në rrjetet rajonale të sigurisë dhe të konsolidonte perceptimin ndërkombëtar të Kosovës si "terror i diskutueshëm" më shumë sesa si shtet sovran dhe funksional. Ky do të ishte një instrument i rëndësishëm strategjik në duart e Beogradit për të kufizuar hapësirën diplomatike dhe lëvizjen ndërkombëtare të Kosovës.

Policia pajiset me 41 vetura të reja për patrullim

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Menaxhmenti i Policisë së Kosovës, në vazhden e ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe atyre logjistike, si dhe të rritjes së vazhdueshme të efikasitetit në punën e policëve patrullues, me qëllim që ata të jenë sa më afër nevojave të qytetarëve, ka ndarë vetura zyrtare për njësitë patrulluese. Përmbushja e objektivave të Planit Zhvillimor Strategjik dhe forcimi i qasjes proaktive ndaj

kërkesave të qytetarëve, tashmë mundësohet më lehtë dhe më shpejt, falë pajisjes shtesë me automjete zyrtare për njësitë patrulluese të stacioneve policore.

Drejtori i përgjithshëm i Policisë, kolonel Gazmend Hoxha, ka vazhduar mbështetjen ndaj departamenteve policore, në këtë rast të rendit publik, duke ndarë dyzet e një (41) vetura të reja, prej tyre 35 limuzina, përfshirë ato Hybride dhe 6

xhipa për mbulimin e zonave patrulluese, në të gjitha drejtoritë rajonale.

Kjo edhe një herë dëshmon përkushtimin e menaxhmentit të policisë për një qasje gjithnjë e më proaktive ndaj qytetarëve, për forcimin e bashkëpunimit, komunikimit dhe reagimit me kohë ndaj kërkesave dhe nevojave të qytetarëve, si dhe për rritjen e mëtejme të besueshmërisë dhe transparencës institucionale.



NË FAKULTETIN FILOZOFIK KA NISUR PROJEKTI “TEACH UP” I ERASMUS CBHE

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Ka nisur në Fakultetin Filozofik projekti “Teach UP Transformative Education and Capacity building for Higher Education Professionals in Political and Social Sciences” i mbështetur nga Erasmus CBHE që synon përmirësimin e mësimdhënies dhe nxënies në fushat e shkencës politike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut në universitetet e Kosovës dhe Shqipërisë.

Gjatë fjalëve përshëndetëse u theksua se projekti “Teach UP” ka ambicie të qarta për transformimin e mësimdhënies, mënyrës së transmetimit të dijes dhe forcimin e partneriteteve e bashkëpunimeve ndërmjet universiteteve dhe me botën akademike ndërkombëtare.



Në ditën e lansimit u nënvizua se projekti është plotësisht në harmoni me vizionin e Universitetit të Prishtinës për transparencë, meritokraci dhe llogaridhënie, për sjelljen e profesorëve dhe studentëve

ndërkombëtarë në UP dhe për dërgimin e stafit dhe studentëve të UP në institucione të njohura akademike në mbarë botën. U përmend edhe projekti i qarkullimit të trurit, një ide e

rektorit prof. Arben Hajrullahu, me të cilin tashmë janë bashkuar me UP-në tre profesorë me integritet të lartë akademik dhe përvojë të madhe ndërkombëtare në universitete të njohura të globit. U vlerësua se tani është momenti i duhur që Fakulteti Filozofik dhe UP të ecin përpara drejt ndryshimeve të nevojshme dhe përshtatjes me tregun e punës që vazhdimisht po evoluon.

Një ndër pikat kryesore të projektit është mundësia e trajnimit të stafit akademik të UP në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Saxion në Holandë dhe Universitetin Paris Lodron të Salzburgut që njihen për ekselencë, inovacion dhe kulturë të lartë akademike. Fjalimet hapëse në lansimin e projektit i mbajtën prorektori

për kërkime shkencore, projekte dhe inovacion prof. Avni Hajdari dhe dekan i Fakultetit Filozofik prof. Bekim Baliqi. Detajet dhe objektivat e projektit u paraqitën nga koordinatori ass. Lirije Palushi. Të martën në ditën e dytë të lansimit të projektit “Teach UP” do të diskutohet për afatet e realizimit, hapat e ardhshëm, arritjen e objektivave dhe do të nxirren përfundimet. Projekti ka partnerë Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Shkencave të Aplikuara Saxion të Holandës, Universitetin Paris Lodron të Salzburgut, Kolegjin Universum, Universitetin Evropian të Tiranës, Universitetin e Nju Jorkut në Tiranë, Institutin për Studime Politike Ekonomike e Sociale (IEPSS) dhe Qendrën për Arsime dhe Zhvillim CED.

PËR HERË TË PARË NË KOSOVË REALIZOHET ZËVENDËSIMI I HARKUT TË AORTËS PËRMES PROCEDURËS FET

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Për herë të parë në Kosovë në Qendrën Klinike dhe Universitare të Kosovës në Shërbimin Klinik të Kardiokirurgjisë është realizuar zëvendësimi i harkut të aortës përmes procedurës Frozen elephant trunk (FET), e krahas saj është zëvendësuar edhe rrënja e aortës (Bentall procedurë). Pacienti para dy vjet kishte disekacion akut të aortës (çarje të aortës) dhe ka pasur intervenim kardiokirurgjik duke bërë zëvendësimin e pjesës ascendente të aortës në një qendër jashtë Kosovës.

Me kalimin e kohës sëmundja ka evoluar dhe është paraqitur nevoja për ri ndërhyrje (Redo OP) kirurgjike për shkak të zgjerimit të rrënjës së aortës, harkut të aortës, si dhe dëmtimit të valvulës aortale. Ekipi operator i udhëhequr nga prof. dr. Omer Xhemali, drejtor i Kardiokirurgjisë së Spitalit Universitar të Cyrihut, njëkohësisht udhëheqës i Aleancës për Kardiokirurgji (Spitali Universitar i Cyrihut, Spitali i qytetit të Cyrihut dhe Spitali kantonial i Anierihtut), dr. Petar Risteski dhe anesteziologjia dr. Bettex Dominique, së bashku me ekipin vendor të kardiokirurgjeve dhe



anesteziologëve të Shërbimit Klinik të Kardiokirurgjisë kanë realizuar Frozen elephant trunk dhe Bentall procedurë,

operacion i kryer për herë të parë në Kosovë. Operimet e tilla janë nga më komplekset në kardiokirurgji, të

kushtueshme dhe njëherësh realizohen vetëm në qendra ekselente të kardiokirurgjisë. Bashkëpunimi i ndërsjellë me klinika me repute botërore, siç është ajo e Universitetit të Cyrihut të Zvicrës paraqesin hap drejt zhvillimit të kardiokirurgjisë me metoda të avancuara, të cilat në të ardhmen do të shtohen në numrin e procedurave operative kardiokirurgjike në QKUK. Stafi i Shërbimit Klinik të Kardiokirurgjisë në QKUK ka njoftuar qytetarët se për çdo nevojë sa iu përket sëmundjeve të zemrës, mund të drejtohen në QKUK, pa pasur nevojë të kërkojnë ndihmë në qendra të tjera jashtë QKUK-së.

Ukë Rugova i hyn garës për deputet

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Në ditëlindjen e ish-presidentit Ibrahim Rugova, kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka pranuar me nderimin më të madh kërkesën e familjes Rugova që Ukë Ibrahim Rugova të jetë pjesë e listës zgjedhore në

zgjedhjet e 18 dhjetorit. “Sot, në 81-vjetorin e lindjes së arkitektit dhe prijësit tonë, vizitova zonjën Fana dhe Familjen Rugova. Në këtë vizitë zyrtarizua dhe përfshirjen e Ukës në garën e radhës. Ukë, të priftë e mbara në këtë garë. Me zonjën Fana

biseduam edhe për rugën e filluar tre dekada më parë; për sakrificat e heshtura që e ndoqën; për vendosmërinë që nuk u thye asnjëherë, edhe kur Kosova ishte në udhëkryqin më të rrezikshëm të historisë së saj moderne. Dhe sot, kur shteti

ynë përballat ame sfida të reja, mesazhi i Rugovës mbetet po ai: forcë paqësore, përkushtim demokratik, orientim të pandryshuar drejt botës perëndimore. Presidenti ka vetëm ditëlindje”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”.



FKGK-ja arrin një miliard euro kredi të garantuara

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) ka arritur një miliard euro kredi të garantuara, ndërsa ka mbështetur rreth 13 mijë biznese në Kosovë.

FKGK me kreditë e garantuara ka kontribuar në krijimin e mbi 33 mijë vendeve të reja të punës në të

gjithë Kosovën, duke kontribuar drejtpërdrejt në mirëqenie dhe zhvillim.

Drejtori menaxhues në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, Besnik Berisha, duke e konsideruar vitin 2025 si vitin më të mirë të operimit të tyre, potencoi se vlera e garancisë ka arritur deri

në 519 milionë euro.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka një bazë të kapitalit prej 105 milionë eurosh.

Berisha i listoi disa nga kontribuuesit më të mëdhenj të themelimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, teksa shtoi se si Fond kanë shtatë dritare

garantuese.

Drejtori menaxhues i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Besnik Berisha, deklaroi se në portofolin e Fondit pjesëmarrja e bizneseve me pronësi gra është vetëm 15 %. Ai theksoi se si Fond kanë ndikuar në rritjen e vendeve të reja të punës me një shifër mbi



33 mijë punësime të reja. Berisha tha se deri tani kanë paguar 4.4 milionë euro dëme nga humbjet kreditore të bankave partnere.

SUPERFUQITË FINANCIARE TË SHEKULLIT XXI: KORPORATAT PO ZËVENDËSOJNË SHTETET

Shkruan: Nazmi JUSUFI

Shekulli XXI po shënon një ndryshim historik në shpërndarjen e pushtetit ekonomik global. Ndryshe nga periudhat e mëparshme, ku shtetet kishin rolin kryesor në kontrollin e tregjeve, rezervave monetare dhe politikave fiskale, sot korporatat shumëkombëshe po bëhen aktorë dominues, shpesh me ndikim më të madh se disa qeveri kombëtare. Kapitali i tyre i pakufizuar, shtrirja ndërkombëtare dhe kontrolli mbi teknologjitë e avancuara i kanë shndërruar në superfuqi financiare të reja, me peshë të krahasueshme me fuqinë e shteteve tradicionale. Shembuj konkretë përfshijnë



Apple, me kapital më të madh se GDP-ja e shumë shteteve të mesme; Amazon, që kontrollon zinxhirët globalë të furnizimit dhe infrastrukturën cloud; Alphabet (Google) dhe Microsoft, që përcaktojnë

standarde globale në teknologji dhe inteligjencë artificiale; si dhe Tesla dhe NVIDIA, që kanë ndikim strategjik në tregun automobilistik, energjetik dhe teknologjik. Këto kompani nuk janë më thjesht aktorë

ekonomikë, por institucione që formësojnë ekonominë globale, vendosin ritmet e inovacionit dhe ndikojnë politikisht në nivel ndërkombëtar.

Ky fenomen ka implikime të rëndësishme për shtetet. Ato shpesh nuk mund të konkurrojnë me fleksibilitetin dhe shpejtësinë e korporatave, ndërkohë që ndikimi fiskal dhe politik i këtyre të fundit rrit pabarazinë ekonomike dhe bën që vendimmarrja globale të mos reflektojë më interesin publik. Për më tepër, korporatat shpesh krijojnë standarde dhe infrastruktura teknologjike që shtetet nuk arrijnë t'i rregullojnë në kohë, duke vendosur një realitet ku pushteti ekonomik dhe teknologjik është në duart e

aktorëve privatë.

Në këtë kontekst, sfida kryesore e shekullit XXI është ruajtja e balancës midis interesit publik dhe ndikimit korporativ. Shtetet që investojnë në teknologji, reformojnë administratat publike dhe krijojnë politika fleksibile industriale mund të mbeten relevante në ekonominë globale. Ndërsa ato që nuk adaptohen, rrezikojnë të mbeten periferike në një rend ekonomik ku superfuqitë nuk burojnë nga territori, por nga kapitali dhe teknologjia.

Ky transformim kërkon reflektim të thellë akademik dhe zhvillimin e mekanizmave të rinj për të siguruar që ekonomia globale të mos dominojë mbi demokracinë, barazinë dhe interesin publik.

ÇITAKU ME AKUZA NDAJ LV-SË: PASUROI 'MAFINË ENERGJETIKE' DHE BLOKUI PROJEKTET JETIKE

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Sekretarësja e përgjithshme e PDK-së, Vlora Çitaku, ka hedhur akuza të forta ndaj Lëvizjes Vetëvendosje, duke thënë se kjo parti ka penguar sistematikisht projektet energjetike të vendit që nga themelimi i saj. Në "Facebook", Çitaku tha se Vetëvendosja prej ditës së parë si parti politike, në mënyrë aktive dhe shpeshherë edhe me dhunë, ka sabotuar çdo iniciativë të institucioneve të Republikës së Kosovës për t'i ndërtuar kapacitetet tona energjetike. Ajo përmendi disa projekte të rëndësishme, përfshirë Termocentralin "Kosova e Re" dhe projektin amerikan të gazpërçuesit. "Nga Termocentrali Kosova e Re e deri te projekti amerikan i



gazpërçuesit, LV-ja ka kundërshtuar dhe bllokuar çdo përpjekje për zhvillim", u

shpreh ajo. Sipas Çitakut, pasojat e këtyre vendimeve janë ndier drejtpërdrejt te

qytetarët dhe bizneset. "Ata e bllokuan Kosovën, i rënduan familjet dhe prodhuesit

vendorë me çmime të papërbalueshme dhe pasuruan mafinë energjetike", deklaroi ajo, duke shtuar se rastet e fundit të përfolura në sektorin energjetik janë vetëm sipërfaqja e një problemi më të thellë. "Nagipi e Martini janë vetëm maja e ajsbergut, rrënjët duken shumë më të thella", ka shkruar Çitaku. Çitaku e cilësoi pavarësinë energjetike si një çështje të sigurisë kombëtare dhe kërkoi ndryshim politik në zgjedhjet e 28 dhjetorit. "Sot pavarësia energjetike nuk është vetëm çështje ekonomike. Është çështje e sigurisë kombëtare. Më 28 dhjetor kësaj mendësie i vjen fundi. Ata po e shohin, prandaj janë në panik", përfundoi ajo.

Kurti: Numri i bizneseve të reja është rritur më shumë se në çdo qeveri para nesh

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka deklaruar se gjatë mandatit të tij numri i bizneseve të reja të regjistruara është rritur çdo

vit, duke tejkaluar nivelet e të gjitha qeverive të mëparshme. Ai ka theksuar se shtimi i bizneseve po reflekton një ekonomi në rritje. "Përgjatë këtij

mandati, numri i bizneseve të reja të regjistruara është ngritur vit pas viti dhe ka qenë më i lartë se në çdo vit tjetër para qeverisjes sonë. Shtim biznesesh në

ekonomi që rritet", ka shkruar Kurti në "Facebook", teksa ka shpërndarë një deklaratë të Hekuran Muratit në lidhje me këtë temë.



SHQIPTARËT PËRBALLË TË KALUARËS KOMUNISTE

A janë “përballur”, a i kanë “mbyllur llogaritë”, a kanë “bërë paqe”, shqiptarët me të kaluarën e tyre komuniste? Janë pyetje që i kam dëgjuar apo lexuar shpesh nga gazetarë, studiues, por edhe vizitorë të huaj ndërkohë që në shoqërinë shqiptare ato mungojnë thuajse krejtësisht

Nga: Fatos LUBONJA

Qoftë nga termat “përballje”, “mbyllje llogarish”, “paqe”, qoftë nga gjuhët e përdorura, por edhe nga përvoja e vendeve prej nga vijnë të huajt ato përmbajnë sfumatura të ndryshme kuptimore e emocionale. Gjithsesi, përtej këtyre sfumaturave, ideja që të sugjerojnë, ashtu siç i rreshtova, është se “përballja” konsiderohet si faza e parë, kushti për fillimin e një procesi që do të na çonte te fazat e mëtejshme: të “mbylljes së llogarive” dhe të arritjes së “paqes”.

Duke kërkuar t’u jap përgjigje pyetjeve mbi raportin e shqiptarëve me të kaluarën e tyre komuniste ideja e parë që më ka ardhur në mendje ka qenë në formën e pyetjes: pse shqiptarët ia kanë shtruar pak ose aspak vetes këto pyetje dhe ç’kuptim ka fakti që këto i bëjnë të huajt? Pra, reflektimi im është nisur nga nevoja për të kuptuar e shpjeguar shkaqet e heshtjes së shoqërisë ndaj këtyre pyetjeve. Një heshtje që mban në barkun e vet edhe shkaqet e dështimit të lindjes së një debati mbi çështjet që shtrojnë këto pyetje.

Në editorialin e këtij dynumërshi të Përpjekjes kushtuar raportit të shqiptarëve me të kaluarën komuniste, duke iu bashkuar autorëve të tij të shumtë, do përpiqem të hedh disa refleksime që synojnë të kuptojnë se në ç’gjendje është deri më sot faza e parë: ajo e përballjes me të kaluarën, si është bërë ajo, dhe më tej: për aq sa ç’është bërë, a është nisur nga qëllimi për ta na çuar drejt “mbylljes së llogarive” dhe “paqes”, apo na ka çuar në drejtime të tjera, të gabuara - siç më rezultoi. Do të përpiqem të hulumtoj gjithashtu shkaqet e marrjes së këtyre drejtimeve të gabuara, dhe, më në fund, të sugjeroj se ç’duhet bërë dhe si duhet bërë një kthesë drejt një përballjeje/debati mbi të kaluarën, që do të na çonte vërtet në mbyllje llogarish dhe në paqe sociale, gjithë pa i konsideruar këto të dyja si arritje përfundimtare, por si synime orientuese të shoqërinë përdrejt të vërtetës dhe lirisë të konceptuara këto si produkte të

dialogut të pandërprerë mes njerëzve.

Koment i një studimi si vështrim i parë

Nuk mohohet se në botën shqiptare kanë qarkulluar e qarkullojnë disa tema të rëndësishme që evokojnë përballjen me të kaluarën të tilla si: dënimi moral e politik i krimeve të komunizmit, dënimi ligjor i autorëve të këtyre krimeve, roli i popullit dhe roli i inteligjencës në promovimin e atij regjimi, roli i të kaluarës historike, kërkiti ndjesë, falja, integrimi në shoqëri i viktimave, hapja e dosjeve të Sigurimit të shtetit, lustracioni, gjetja e varreve të të vdekurve nëpër burgje dhe të të dënuarve me vdekje, përkujtimi dhe përkujtimoret mbi atë kohë, dëshmipërblimi moral dhe material i viktimave, etj.. Janë tema të cekura andej këtej nga politika, mediat, shoqëria civile apo individë të ndryshëm, më së shumti duke u instrumentalizuar për qëllime politike nëpërmjet prekjës së anëve emocionale të problemit, por pa u trajtuar në mënyrë të përthelluar në emër të ndërgjegjësimit mbi nevojën e përballjes me të kaluarën. Me këtë përthellim kuptoj një kombinim metodash studimore objektive dhe subjektive, ku me të parat kam parasysh kërkimin e të dhënave të matshme me numra apo shifra, si p.sh. numri i atyre që janë dënuar për krimet e asaj kohe, numri i varreve të gjetura, i atyre që kanë kërkuar ndjesë, i atyre që kanë falur, i shifrave të dëshmipërblimeve, të objekteve muzeale apo përkujtimeve që ftojnë për reflektim, e të tjera; kurse me të dytat intervista njerëzish mbi temat në fjalë apo mbi pyetjen më të përgjithshme se në çfarë mase e ndjejnë ata se ka pasur një ballafaqim me të kaluarën në emër të mbylljes së hesapeve të shoqërisë me të, nëse kanë bërë ata paqe me të apo se sa ata ndiejnë se e kaluara rëndon mbi të tashmen e tyre - qoftë për viktimat kjo, qoftë edhe për persekutorët.

Siç e thashë, nuk mungojnë prova aty këtu për t’i prekur këto tema, por ato kanë mbetur si



shtigje qorre, që nuk kanë çuar dot në një hapësirë dialogu publik mes palëve të ndryshme me të cilat kam parasysh si brezat e ndryshëm ashtu edhe zgjedhjet dhe fateve e tyre të ndryshme në atë kohë.

Një prej këtyre sprovave të mbetura në mes të rrugës është edhe një studim i kryer nga organizata jofitimprurëse IDRA në vitin 2015 me titull: “Njohuritë dhe perceptimet e publikut për të shkuarën komuniste” dhe nëntitull: “në kuadrin e ndërtimit të një platforme të dialogut kombëtar rreth shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë regjimit të mëparshëm komunist në Shqipëri” (kryer me iniciativën dhe sponsorizimin e OSBE-së dhe Ambasadës Gjermane.)

Këtu tërheq edhe një herë vëmendjen për një fenomen që do t’i rikthehem edhe herë të tjera: fakti se janë të huajt që e ngacmojnë këtë tematikë.

Studimi i IDRA-s është bazuar në anketimin e tre grupmoshave: 16-35 vjeç, 35-55 vjeç dhe mbi 55 vjeç, të ndara edhe sipas gjinisë edhe sipas tri zonash gjeografike. Të anketuarve (rreth 1000) u janë drejtuar pyetje të tilla si: a është problem e kaluara komuniste për ju?; sa e njihni atë?; sa të interesuar jeni ta njihni?; çfarë perceptimi keni për atë regjim? etj..

Përshtypja e përgjithshme që të le studimi, qoftë nëpërmjet përgjigjeve, qoftë edhe nëpërmjet disa nga pyetjet e formuluar nga studiuesit, është se shoqëria shqiptare ka mbetur në një gjendje foshnjore në përballjen me të kaluarën, çka shpjegon edhe pse procesi, që siç shihet nga nëntitulli është konceptuar si një ndihmesë për të nxitur një dialog kombëtar

mbi këto tema: pra për t’i dhënë nismën kalimit nga përballja te mbyllja e llogarive dhe nga kjo te paqja sociale - nuk ka vazhduar, madje edhe pse nuk ka filluar më herët nga aktorë shqiptarë.

Le të komentoj disa momente të këtij studimi:

Të pyetur se sa u intereson njohja e të kaluarës komuniste vetëm 8% e shqiptarëve shfaqen “shumë të interesuar”, 20% “pak a shumë të interesuar”, 21% “pak a shumë të painteresuar” dhe 50 % “aspak të interesuar”. Ata konsiderojnë si më të rëndësishme se sa njohjen e të shkuarës komuniste arsimin, shëndetësinë, korrupsionin / keqkëqerisjen, mosndëshkueshmërinë, ekonominë, ndotjen e mjedisit, rendin dhe sigurinë.

Të pyetur mbi burimet se nga marrin informacion mbi të kaluarën komuniste (pa u bërë dallimi nëse flitet për aspekte pozitive apo negative të saj) vetëm 7% pohojnë se i marrin këto nga shkolla.

Kur u kërkohet të bëjnë krahasimin midis të kaluarës komuniste dhe të sotmes (rikujtoj se studimi është kryer në vitin 2015) shumica dërmuese ose “pajtohen plotësisht” ose “pajtohen” (këta bëhen mbi 80%), me përgjigjen e ofruar nga anketuesit sipas së cilës në atë kohë kishte “siguri jete shumë më të madhe, arsimim më cilësor, mundësi punësimi më të mëdha, kishte më shumë siguri të punës, më shumë qëndrueshmëri politike, më pak korrupsion.”

Të pyetur mbi rolin e Enver Hoxhës në historinë e Shqipërisë nëse ka qenë pozitiv apo negativ 45 % përgjigjen se ka qenë

pozitiv dhe 42% se ka qenë negativ.

Kur u është shtruar pyetja nëse duhet lejuar një kompani private të rihapë e shfrytëzojë një minierë ku kanë vuajtur dënimin në formën e punës së detyruar të burgosurit politikë (duket se kanë parasysh minierën e Spaçit që ka shërbyer si vend vuajtje dënimi që nga viti 1968 deri në 1990 dhe ku punon sot një kompani private e huaj) 24% kanë thënë se “përfitimet ekonomike janë prioriteti i vendit prandaj kompania duhet lejuar të punojë në zonën e ish kampit, kudo dhe pa kufizime,”; 58% kanë thënë se “duhet lejuar me disa kufizime” dhe vetëm 10% janë shprehur në emër të ruajtjes tërësisht të atij vendi si memorial i së kaluarës.

Qasja e studiuesve

Përsa i përket qasjes së studiuesve po veçoj një moment kur ata, pasi kanë shtruar pyetjen: “pse kemi nevojë ta njohim të shkuarën komuniste?”, kanë formuluar tri përgjigjet e mëposhtme, mbi njërin prej të cilave duhet të verë kryq çdo i anketuar:

- “Ka disa aspekte të së shkuarës komuniste që duhen të njihen nga brezat e rinj.”
- “E shkuara komuniste duhet të shërbejë si një shembull i barazisë shoqërore, vullnetarizmit civil dhe sensit të komunitetit për brezat e rinj.”
- “E shkuara komuniste është një periudhë e tmerrshme e cila duhet të harrohet tërësisht dhe të mos i mësohet gjeneratës së re.”

Vlen të komentohet ky moment i studimit, në kontekstin e gjithë përgjigjeve që kanë dhënë të

anketuarit, për dy arsye: Së pari, për faktin se 22% “pajtohen plotësisht” dhe 56% “pajtohen” (së bashku 78%) me përgjigjen e dytë: pra se e shkuara komuniste duhet të shërbejë për brezat e rinj si shembull i “barazisë shoqërore”, “vullnetarizmit civil” dhe “sensit të komunitetit”.

Së dyti, pasi në formulimin e përgjigjeve nga anketuesit mungon përgjigja se periudha komuniste duhet të njihet dhe jo të harrohet pasi njohja dhe kuptimi i shkaqeve që e kanë prodhuar atë “periudhë të tmerrshme”, jo vetëm na shërben për t’u përballur me traumën që ajo na ka shkaktuar, nisur nga ideja e kurimit të saj për të arritur paqen individuale dhe shoqërore, por edhe sepse njohja e së keqes na duhet për të ndërtuar instrumente institucionale, mendorë dhe shpirtërorë për të mos lejuar përsëritjen e saj.

Le të përpiqem të bëj një kategorizim të shoqërisë shqiptare nisur si nga analiza e përgjigjeve të të anketuarve, ashtu dhe nga mungesa e përgjigjes që formulova më sipër, që sipas meje është tejet domethënëse. Vë në dukje se kur kategorizojmë gjithmonë kryejmë një operacion simplifikikimi, duke reduktuar kompleksitetin e individëve, në disa karakteristika të përbashkëta nisur nga ajo më kryesorja tek ato dytësoret.

E përbashkëta më e madhe e shumicës së shqiptarëve të intervistuar - që janë një shabllon i shoqërisë shqiptare - është fakti se ata i trajtojnë këto dy periudha si të ndara, pa lidhje organike me njëra tjetrën, gati si të përkundërta. Pra, kur ata shprehen se konsiderojnë si më të rëndësishme se sa njohja e të shkuarës komuniste arsimin, shëndetësinë, korrupsionin/keqqeverisjen, mosndëshkueshmërinë, ekonominë, ndotjen e mjedisit, rendin dhe sigurinë, nuk arrijnë të mendojnë se këto kanë ndonjë lidhje edhe me të shkuarën dhe se ndërgjegjësimi për këtë të shkuar mund të ndihmojë edhe në përmirësimin e së tashmes.

Brenda kësaj kategorie, le ta quaj “të pavetëdijshmit”, do të dalloja këto nënkategorie:

Të pavetëdijshmit “e pavuajtur”

Në këtë nënkategori do të fusja individët që kanë të përbashkët faktin se nuk e kanë vuajtur drejtpërdrejt apo familjarisht persekutimin e regjimit në formën e burgimeve, internimeve, dëbimeve, duke mbajtur mbi shpinë damkën e “armikut të klasës”. Në spektrin e kësaj kategorie, që i vura në thonjëza epitetin “e pavuajtur”, do të fusja që nga aktorët e këtij persekutimi dhe familjarë të tyre deri tek ajo shtresë që rëndom quhet zona gri, e cila ka edhe ajo larmitë e veta.

Brenda kësaj nënkategorie do të dalloja tri ndarje kryesore: E para: ata që nuk janë të

vetëdijshëm për traumën jo vetëm të të vuajturve, por edhe atë të vetes, për shkak të indoktrinimit, cektësisë së mendimit, apo për shkak se e kanë fshirë nga kujtesa të keqen e asaj kohe për të mos mbajtur përgjegjësi para vetes dhe të tjerëve. Duke iu referuar studimit kam parasysh ata që çmojnë “arritjet” e atij regjimi, që e konsiderojnë periudhën e komunizmit si “shembull i barazisë shoqërore”, “vullnetarizmit civil”, “sensit të komunitetit”, që rolin e Enver Hoxhës e cilësojnë si pozitiv. Në këtë kategori mund të hyjnë edhe një pjesë të rinjsh që nuk e kanë jetuar atë kohë, por që janë indoktrinuuar nga ky diskurs.

E dyta: ata, që kryesisht kanë qenë fëmijë ose të rinj kur ra regjimi, apo që kanë lindur pas rënies së tij, që shfaqen të painteresuar për njohjen e së kaluarës sepse kanë vështruar/vështrojnë drejt së ardhmes, pa e ditur se e kaluara i ndjek pas. Te kjo ndarje do të fusja jo vetëm ata që rrjedhin nga familje të privilegjuara në atë kohë, si dhe ata që rrjedhin nga zona gri, por edhe një pjesë jo të vogël të rinjsh që, pikërisht pse e u janë persekutuar familjarët, kanë zgjedhur t’i ikin asaj të kaluare.

E treta: ata që megjithëse janë të vetëdijshëm për traumat e asaj kohe, ndihen ashtu dhe aq të zhgënjyer me të tashmen përsa i përket sigurisë së jetës, gjendjes së arsimit, mundësisë së punësimit, korrupsionit, pabarazisë, saqë parapëlqejnë atë kohë përpara kësaj.

Të pavetëdijshmit e vuajtur

Te kjo nënkategori do të fusja një numër të rëndësishëm të persekutuarish, apo familjarësh të tyre, që i shohin dy periudhat si vazhdim të njëra-tjetrës me arsyetimin e dëshpëruar se në pushtet kanë vazhduar të mbesin trashëgimtarët e ish-persekutorëve të tyre. Ngulmoj t’i fus këta si nënkategori te të pavetëdijshmit, pra, paradoksalisht, bashkë me ata që e trajtojnë të kaluarën komuniste dhe të tashmen si dy histori të përkundërta, pasi te vazhdimësia mbi bazë familjare që shohin këta te dy periudhat gjej diçka thelbësore që i bashkon: përjetimi i së tashmes pa e lidhur në kuptimin e saj më të thellë me të kaluarën. Kjo nënkategori duket sikur vazhdon përjetimin e traumës së vjetër pa dalluar qartë se jeton në një realitet tjetër, çka të kujton një ese të Frojdit të titulluar “Konsiderata aktuale...” (1915) ku flitet për dy kohë psikologjike të njeriut: kohën e kaluar të traumës, që nuk kalon por është gjithmonë prezente e palëvizshme në jetën e tij, dhe kohën e së tashmes. Në këtë kuptim, të dyja nënkategoritë kanë të përbashkët moselaborimin e traumës nëpërmjet njohjes/kuptimit të shkakut të saj të thelbësor, për rrjedhojë moskapërcimin e saj.

Për shkak të dominimit të kategorisë së madhe të të pavetëdijshmëve në politikë dhe në jetën social-kulturore shoqëria shqiptare karakterizohet nga përplasja pa dialog e pa sintezë e diskurseve të këtyre dy shtresave emocionalisht të përkundërta, ku kategoritë e vjetra si “komunist”, “ballist”, “tradhtar”, “sigurims”, përdoren rëndom për të interpretuar të keqen e të sotmes dhe, ku anasjellatas kategoritë e reja si “oligark”, “trafikant”, “kleptokrat”, “i korruptuar”, përdoren për të interpretuar të djeshmen në një mish-mash pa asnjë lloj rendi konceptual të ndërtuar nëpërmjet mendimit kritik, çka nuk lejon interpretimin drejt as të njërës kohë as të tjetrës. Një tregues i këtij moskuptimi është edhe reagimi që shoqëroi në media raportin e IDRA-s ku mbizotëroi titulli: “Për shqiptarët s’është më problem komunizmi”, që u interpretua politikisht se nuk ka pse merremi më me të dhe, që e provoi edhe fakti se raporti nuk u pasua me atë që parashikonte nëntitulli i tij: ndërtimin e një platforme të dialogut kombëtar.

Kategoria e munguar ose në zhdukje

Me këtë kategori kam parasysh një pakicë shqiptarësh që të kaluarën nuk e sheh si të përkundërt me të tashmen dhe as si vazhdimësi familjare por që mendon se Shqipëria e postkomunizmit është një vazhdim në shumë aspekte i së kaluarës jo për shkak se janë në pushtet bijtë e komunistëve, por për shkak se është ende dominuese matrica kulturore njerëzore që farkoi dhe u farkua në atë kohë. Është kategoria e atyre që kërkon integrimin e traumës të së kaluarës në vetëdijen kolektive të së tashmes nëpërmjet një autorefleksioni që do të çonte në njohjen e shkaqeve të saj më të thella antropologjike dhe kulturore. Për shkaqe që do t’i cek më poshtë, tridhjetë vjet post komunizëm nuk e kanë ndihmuar aspak lindjen dhe rritjen e kësaj kategorie, përkundrazi do të thoja se individët e paktë që i përkasin kësaj kategorie, ku modestisht bën pjesë edhe autori i këtyre refleksioneve, janë në zhdukje. Mungesa apo zhdukja e individëve të kësaj kategorie, që e ve në dukje edhe studimi që mora në analizë nëpërmjet përgjigjes së munguar rreth pyetjes se pse duhet ta njohim të kaluarën komuniste, është edhe një nga treguesit indirektë të mospërballjes së shqiptarëve me të kaluarën apo i drejtimit të gabuar të kësaj përballeje.

Një tjetër metodë

Duke u nisur nga qasja e atyre që e shohin të keqen te matrica kulturore, përgjigjen e munguar të studiuesve të shoqatës IDRA mund ta formulojmë edhe në

formën: të kaluarën komuniste duhet ta njohim që të mos përsërisim të keqen, ose, më thjesht: që të mos sillemi me njëri-tjetrin ashtu siç jemi sjellë në atë kohë.

Duke u nisur nga kjo ide, do të ndërtoja një tjetër metodë për të vlerësuar se sa dhe si janë përballur shqiptarët me të kaluarën: hulumtimin e sjelljes së shqiptarëve ndaj njëri-tjetrit në kohën e sotme. Me fjalë të tjera: në ç’masë e në ç’mënyrë përsëritet e kaluara në strukturat politike, ekonomike, sociale, kulturore që kanë ndërtuar shqiptarët në të tashmen për shkak të mospërballimit me të kaluarën.

Për këtë le të bëjmë një krahasim midis regjimit që kemi jetuar dhe atij që jetojmë duke rreshtuar disa karakteristika themelore, tashmë të mirëstudiuara, të regjimeve totalitare siç ka qenë, deri në ekstrem, edhe ai shqiptar. Një parti e vetme shtet;

- Një lider në krye të saj që identifikohet me partinë dhe me popullin;

- Një ideologji që duhet ta përqafojë i gjithë populli, e cila promovohet nëpërmjet propagandës, artit, letërsisë, historiografisë, arsimimit etj.;

- Kontrolli i plotë i kësaj partie/shtet mbi mas-mediat;

- Kontrolli i plotë i kësaj partie/shtet mbi ekonominë;

- Një shoqëri civile që quhej “organizata masë” që shërben si ingranazh që lidh popullin me partinë/shtet;

- Sistemi i frikësimit apo nënshtrimit me kampe-burgje dhe internime të atye që i kundërvihen politikave të kësaj partie;

- Zgjedhje të garantuara me fitore plebishitare që nuk shpalleshin 100% për të lënë idenë se njerëzit ishin të lirë të votonin edhe kundër.

Në rastin shqiptar këto karakteristika janë shfaqur në mënyrën më radikale për çka flasin tri fakte shtesë tejet domethënëse:

- Shqipëria ndryshe nga vendet e tjera ish-komuniste mbeti staliniste deri në fund;
- Në vitin ‘67 kemi ndalimin e fesë;
- Vendi jetoi një izolimi thuajse total nga pjesa tjetër e botës.

Pyetja ngrihet: Sa dhe si regjimi i ri që kemi ndërtuar i shembëllen atij të së kaluarës pas mbi tridhjetë vjetësh, çka indirekt të bën të mendosh se sa dhe si janë përballur me të kaluarën shqiptarët? Më rezulton se mjafton të zëvendësosh togfjalëshin i gjithë populli: me shumica e popullit apo kontrollin e plotë me kontrollin e shumicës për të konstatuar ngjashmëritë. Pra sot mund të themi se kemi:

- Një parti të maxhorancës të udhëhequr nga një udhëheqës i gjithëpushtetshëm në krye të saj që identifikohet me partinë dhe me shumicën e popullit dhe që kontrollon shumicat e të katër pushteteve (madje edhe një pjesë të opozitës);

- Një ideologji-vizion për botën

që përqafohet nga shumica e popullit dhe që promovohet nga shumica e mjeteve të informacionit;

- Kontrollin e shumicën së mediave nga partia shtet;

- Kontrollin e shumicës së aktiviteteve ekonomike dhe aktorëve ekonomikë nga kjo parti-shtet;

- Një shoqërie civile shumica e organizatave të së cilës, që sot quhen OJQ, shërbejnë si ingranazhi që lidh shumicën e popullit me partinë-shtet;


- Një sistem frikësimi dhe nënshtrimi që nuk ushtrohen nëpërmjet burgjeve dhe internimeve, por nëpërmjet kërcënimit të bukës së gojës, kontrollit të ekonomisë, të drejtësisë, të administrtatës, sistemit të patronazhistëve dhe krimit të organizuar;

- Zgjedhje me fitore të garantuar me rezultat gjithmonë në rritje përballë një opozite të përçarë dhe të blerë.

Duke iu referuar përvojave historike mund të thuhet se Shqipëria e sotme i përngjet më së shumti një regjimi autoritar të ekstremit të djathtë që shtyp liritë dhe të drejtat e njeriut në emër të një oligarkie të lidhur ngushtësisht me krimin e organizuar. Por, po t’i hysh më thellë regjimit komunist të ekstremit të majtë, në thelb të të dy regjimeve vihet re një ngjashmëri thelbësore, të ekstremeve që puqen: edhe ai nuk ishte tjetër veçse pushtet i një pakice që quhej nomenklaturë, që shtypte dhe shfrytëzonte shumicën e nënshtruar prej saj. Të dy palët i karakterizon shfrytëzimi dhe tjetërsimi i njeriut që trajtohet vetëm si mjet dhe jo edhe si qëllim. Vendin e nomenklaturës së djeshme e kanë zënë pakica e të pasurve (politikanë + narko-oligarkët) të shpëputur nga populli deri në mbylljen e tyre në gated communities të rrethuar me mure dhe me roje që të kujtojnë Bllokun famëkeq të udhëheqjes komuniste.

Edhe përsa i përket izolimit të kufirit të djeshëm përballë hapjes së sotme mund të flitet përsëri për dy ekstreme që puqen sepse, ndërsa i pari i mbante shqiptarët të rrethuar me tela me gjemba në gjendje skllavërie, i dyti inkurajon ikjen e tyre në masë nga vendi për t’u kthyer në qytetarë të dorës së dytë në vendet ku emigrojnë. Në thelb në të dy rastet ata janë pa asnjë ndikim apo pjesëmarrje në fatet e vendit, në të dy rastet pa një jetë autentike. Janë dy forma shkatërrimi të shumicës në emër të sundimit të pakicës.

Pra, jo vetëm analiza e perceptimit dhe vlerësimit që japin shqiptarët për të kaluarën komuniste, siç e pamë duke analizuar studimin e shoqatës IDRA, por edhe përsëritja e fenomeneve të pushtetit të djeshëm në regjimin autoritar të sotëm të çojnë në përfundimin se shqiptarët kanë dështuar - duke marrë një rrugë të gabuar - në përballjen me të kaluarën komuniste. /*Editorial i numrit të ri të revistës “Përpyekja”/*



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Jeronimo Sarin emërohet trajner i Golden Eagle Yllit

SUHAREKË, 2 DHJETOR - Golden Eagle Ylli ka zyrtarizuar sot trajnerin e ri të ekipit, Jeronimo Sarin, i cili vetëm para pak ditësh është larguar nga pozita e

kryetrajnerit të Vëllaznimit. Klubi suharekas ka lëvizur shpejt për ta siguruar strategun që në stinorin e kaluar e udhëhoqi Vëllaznimit drejt një prej

sukseseve më të mëdha në histori, titullit kampion të Ligës Unike. Emërimi i Sarin vjen në një çast vendimtar për Yllin, që synon të rikthehet në garë

për trofetë kryesorë. Me përvojën dhe autoritetin e tij, pritët që trajneri kroat t'i sjellë stabilitet ekipit dhe ta rikthejë identitetin luftarak në parket.



NDESHJE TË FORTA NË KUPËN E KOSOVËS NË BASKETBOLL

Në ambientet e Federatës së Basketbollit të Kosovës është hedhur shorti për Kupën e Kosovës në basketboll. Në çerekfinale do të ketë shumë ndeshje interesante, ku do të përballen Bashkimi me GO+ Peja, derisa fituesja aktuale e Kupës, Trepça, do të ndeshet me Golden Eagle Yllin. Përballje e barabartë shihet ajo ndërmjet Rahovecit 029 dhe Borës, si dhe

shumë sfidë interesante ndërmjet Vëllaznimit dhe Sigal Prishtinës. Sipas sistemit, dy ndeshje do të zhvillohen në çerekfinale dhe skuadrat më të mira nga të dyja ndeshjet, kualifikohet në gjysmëfinale që, po ashtu, zhvillohen dy ndeshje për t'u kualifikuar në finalen e madhe. Në gjysmëfinale fituesi i çiftit Bashkimi - GO+ Peja do të ndeshet me fituesin e çiftit



ÇEREKFINALET

Bashkimi - GO+ Peja
Trepça - Golden Eagle Ylli
Rahoveci 029 - Bora
Vëllaznimi - Sigal Prishtina

Vëllaznimi - Sigal Prishtina, si dhe fituesi i çiftit Trepça - Golden Eagle Ylli me fituesin e çiftit Rahoveci 029 - Bora. Fituese aktuale është Trepça.

EPOKA E VAR-it DREJT PËRFUNDIMIT, PO VJEN SISTEMI FVS NË FUTBOLL



ROMË, 2 DHJETOR - Seria A mund të jetë pranë një ndryshimi të madh në mënyrën si arbitrohen ndeshjet. Sipas "Il Messaggero", AIA (inteligjenca artificiale) po studion seriozisht sistemin e ri Football Video Support (FVS), i cili aktualisht po testohet në Serinë C dhe që mund ta zëvendësojë plotësisht VAR-in tradicional. Sistemi i ri ndryshon rrënjësisht nga ai që përdoret sot. Me FVS nuk do të ketë më një dhomë qendrore me gjyqtarë video në Lissone. Në vend të kësaj, pranë fushës vendoset një stacion i vogël ku

punon një gjyqtar i pestë. Ky gjyqtar nuk jep mendim dhe nuk sugjeron vendime, ai thjesht i shfaq pamjet për arbitrin kryesor kur kërkohet rishikim. Pjesa më revolucionare e sistemit është roli i trajnerëve. Me FVS, rishikimet nuk bëhen automatikisht, por vetëm kur trajnerët vendosin të kërkojnë sfidë. Çdo trajner do të ketë nga dy kërkesa për ndeshje, të cilat mund t'i përdorë për rastet e zakonshme: gola, penallti, kartonë të kuq direkt ose konfuzion mbi identitetin e lojtarit. Nëse trajneri ka të

drejtë, ai e mban kartën e sfidës; nëse jo, e humbet. Ky ndryshim do ta kthente përgjegjësinë te njerëzit në fushë, tek arbitrit dhe trajnerët, duke shmangur mbështetjen e tepruar të teknologjia dhe te specialistët në dhomën e VAR-it. Sipas AIA-s, loja do të rridhte më shpejt, me më pak ndalesa dhe me më pak polemika, pasi skuadrat vetë do të vendosnin kur ka vërtet nevojë për rishikim. Nëse sistemi FVS funksionon mirë në Serinë C, ai mund të jetë gati të hyjë edhe në Serinë A në të ardhmen e afërt.

FISNIK ASLLANI KUSHTON 30 MILIONË EURO



HOFFENHEIMIN, 2 DHJETOR - Skuadra që dëshiron t'i sigurojë shërbimet e sulmuesit të Kosovës, Fisnik Asllani, duhet të paguajë të paktën 30 milionë euro për kartonin e tij. Ky është çmimi që Hoffenheimi po e kërkon për 23-vjeçarin pas interesimit nga

Bayern Muncheni, Borussia Dortmundi, Barcelona dhe disa skuadra nga Premierë Liga e Anglisë. Mediet gjermane kanë raportuar se Asllani në kontratën e re, të firmosur javë më parë me Hoffenheimin, ka një klauzolë lirimi prej 25 deri në 29

milione euro dhe, sipas të gjitha gjasave, ai do të largohet në verë nëse jo në janar nga ekipi i Bundesligës. Në rast se Asllani shitet për 30 milionë euro, atëherë do të jetë ndër pesë transferimet më të shtrenjta në historinë e Hoffenheimit, ekip me të cilin

ka kontratë deri në vitin 2029. Në sezonin e tij të parë në Bundesligë, Asllani ka shënuar 5 gola dhe ka bërë 2 asistime në 12 ndeshje të luajtura. Në total, Asllani ka 6 gola e 3 asistime në 14 ndeshje të luajtura për Hoffenheimin në të gjitha garat.


Kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, shpallet "Mbrotësi i Vitit 2025" në Serinë A

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Kapiteni i Kosovës dhe muri i mbrotjes dardane, Amir Rrahmani, është shpallur "Mbrotësi i Vitit 2025" në Serinë A. Si kurorëzim i një

sezoni fantastik ai është përfshirë edhe në formacionin më të mirë të kampionatit italian. Pas një sezoni të jashtëzakonshëm me Napolin

kampion, lidërshipi, qetësia dhe dominimi i tij në prapavijë e udhëhoqën skuadrën drejt majës së futbollit italian. Pos të tjerash, urime për

Rahmanin ka shprehur Federata e Futbollit të Kosovës (FFK). "Krenari pa kufij për Amirin!", ka shkruar FFK-ja në faqen zyrtare në "Facebook".



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “DIONI BAU IÇ” Sh.P.K. me seli në Gillogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812172948 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "DIONI BAU IÇ" D.O.O. od Glogovac, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812172948 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “DIONI BAU İÇ” L.L.C. with headquarters Glogoc, has come to the decision to quit its business: 812172948 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Galeria Studio” Sh. P. K. me seli në Lipjan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811882390 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Galeria Studio" D. O. O. od Ljipljan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811882390 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljiivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Galeria Studio” L. L. C. with headquarters Lipjan, has come to the decision to quit its business: 811882390 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgagor – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Alban Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit "Hani Hotit" SH.P.K. me nr. Unik: 811577751.
- Shemsije Rakipi shpall te pa vlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ilmi Bahtjari" Prizren.
- Egzon Makolli shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" Drenas.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjumnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjumnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



CONTRACT NOTICE
SERVICES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 02/12/2025

Procurement No	Training	001	2025	221
----------------	----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English x

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. MujëKrasniqin.n.Ulpiana U1/1		
Town:Prishtina	Postal code:10000	Country:Kosovo
Contact point(s):Zef Shala		Telephone:038-542-865
Email:zefshala@hotmail.com		Fax:038-542-869
Internet address (if applicable):		www.matherteresasociety

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: Profesional training for 343 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo		
II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)		
		X Services
II.1.5) Short description of the object of the contract Profesional training for 343 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo		
II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV) ☐ 93.000.000.-8 ☐		
II.1.7) Variants are accepted No x		
II.1.8) Division into lots NO x		
Profesional training for 343 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo		
II.1.11) Estimated contract value: Approximately 25,000.00		

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months 3 month (from the contract signature) or
Starting 15/12/2025
Completion 14/03/2026

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

III.1.1) Performance security required	NO
III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)	
III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject	No ☒

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2.1) Eligibility Requirements: 1. Certificate of Business Registration 2. Fiscal Number Registration 3. VAT-Certificate if applicable Documentary evidence required Copy of documentary
III.2.2) Professional Suitability: 1.Business Registration Certificate 2.List of proposed experts and administrative staff and their cv-s 3 References of previous experience in similar projects Documentary evidence required: Copy of prove documents
III.2.3) Economic and financial capacity 1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo(for Winner Company only) 2. Certificate from Justice that Company and person representative is not on any justice process (for Winner Company only) 3. Company profile Documentary evidence required: Copy of documentary
III.2.4) Technical and professional capacity 1.Business Registration Certificate 2.List of proposed experts and administrative staff and their cv-s 3 References of previous experience in similar projects Documentary evidence required: Copy of prove documents

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession	No ☒
III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service	Yes ☒

SECTION IV: PROCEDURE

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

IV.1.1) Type of Procedure
Open

IV.2) AWARD CRITERIA

Lowest price

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract	No	☒
IV.3.2) Conditions for obtaining <i>tender dossier</i> Time limit for receipt of requests for <i>tender dossier</i> : date 08/12/2025		
Payable documents	No	☒
IV.3.3) Time limit for receipt of <i>tenders</i> <i>Date 12/12/2025 time 14:00 place Prishtina</i>		
IV.3.4) Time limits is shortened for submission of <i>tenders</i>	☒	no
IV.3.5) Is tender security needed:	No	☒
IV.3.6) Tender validity period: date: 12/12/2025 days 30 or months1		
IV.3.7) Tender opening meeting: <i>Date 12/12/2025 time 14:30 place Prishtina</i>		

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092,at the address specified in Section I of this Contract notice.
--

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.
--

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales